



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës

Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority



Në mbështetje të Ligjit nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës neni 28, paragrafi 1.10 (Gazeta zyrtare nr. 88, e datës 25.11.2010) si dhe të Ligjit nr. 04/L-226 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës neni 5 dhe neni 7A, paragrafi 2, Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, me datë 14.11.2019, nxjerr këtë:

**RREGULLORE NR. 01/2019 PËR DISA KATEGORI TË
MARRËVESHJEVE TË KËRKIMIT DHE ZHVILLIMIT**

Neni 1
Qëllimi

1. Qëllimi i kësaj Rregulloreje është që të përcaktojë marrëveshjet e kërkimit dhe zhvillimit të cilat përjashtohen, të vlerësojë ndikimin e këtyre marrëveshjeve në tregun përkatës, si dhe të përcaktojë rastet kur këto marrëveshje nuk janë objekt i përjashtimit.

Neni 2
Përkufizimet

1. Për qëllimet e kësaj rregulloreje, zbatohen përkufizimet e mëposhtme:
 - (a) "Marrëveshje e kërkimit dhe zhvillimit" nënkupton një marrëveshje e lidhur midis dy ose më shumë palëve të cilat marrin përsipër kushtet që duhet të plotësohen;
 - (i) kërkimi dhe zhvillimi i përbashkët i produkteve dhe teknologjive të kontraktuara si dhe shrytëzimi i përbashkët i rezultateve të këtij kërkimi dhe zhvillimi,
 - (ii) shrytëzimi i përbashkët i rezultateve të kërkimit dhe zhvillimit të produkteve ose teknologjive të kontraktuara deri tek të cilat ata kanë arritur bashkërisht në pajtim me marrëveshjen e mëparshme midis palëve të njëjta,
 - (iii) kërkimi dhe zhvillim i përbashkët i produkteve ose teknologjive të kontraktuara duke përjashtuar shrytëzimin e përbashkët të rezultateve,
 - (iv) pagesa për kërkimin dhe zhvillimin e produkteve ose teknologjive të kontraktuara dhe shrytëzimi i përbashkët i rezultateve të këtij kërkimi dhe zhvillimi,
 - (v) shrytëzimi i përbashkët i rezultateve me pagesë të kërkimit dhe zhvillimit të

- produkteve ose teknologjive të kontraktuara në pajtim me marrëveshjen paraprake në mes palëve të njëjta, ose
- (vi)** kërkimi dhe zhvillimi me pagesë i rezultateve të produkteve ose teknologjive të kontraktuara duke perjashtuar shfrytëzimin e përbashkët të rezultateve;
- (b)** "marrëveshje" do të thotë një marrëveshje, një vendim nga një shoqatë e ndërmarrjeve ose një praktikë e bashkërenduar;
- (c)** "kërkim dhe zhvillim" do të thotë fitimi i njohurive dhe përvojës në lidhje me produktet, teknologjitë ose proceset për kryerjen e analizave teorike, studimin sistematik ose eksperimentimin, duke përfshirë prodhimin eksperimental, testimin teknik të produkteve ose proceseve, krijimin e lehtësirave të nevojshme dhe fitimin e të drejtave të pronësisë intelektuale për keto rezultate;
- (d)** "produkti" nënkupton mallin ose shërbimin, duke i përfshirë edhe mallrat e gjysëmprodukteve ose shërbimeve dhe produktet ose shërbimet e gatshme;
- (e)** "teknologjia e kontraktuar" nënkupton teknologjinë ose procesin që rezulton nga kërkimi dhe zhvillimi i përbashkët;
- (f)** "produkti i kontraktuar" nënkupton një produkt që rezulton nga kërkimi dhe zhvillimi i përbashkët ose është i prodhuar apo i blerë duke përdorur teknologjitë e kontraktuara;
- (g)** "shfrytëzimi i rezultateve" nënkupton prodhimin ose shpërndarjen e produkteve të kontraktuara ose aplikimin e teknologjive të kontraktuara përkatësisht dhënien apo licencimin e të drejtave të pronësisë intelektuale ose shfrytëzimit të know-how-it të nevojshëm për prodhimin ose aplikimin e tillë;
- (h)** "e drejta e pronësisë intelektuale" nënkupton të drejtën e pronësisë intelektuale, duke i përfshirë të drejtën e pronësisë industriale, të drejtën e autorit dhe të drejtat e ngjashme;
- (i)** "know-how-i" (njohuri dhe përvojë) nënkupton pako të informacionit praktik të patentuar e cila ka rezultuar nga përvoja dhe testimi dhe e cila është sekret, thelbësor dhe i identifikuar;
- (j)** "sekret" në kontekstin e know-how-it nënkupton se ai know-how nuk është përgjithësisht i njohur ose lehtë i qasshëm;
- (k)** "i rëndësishëm" në kontekstin e know-how-it do të thotë se ai know-how është i rëndësishëm dhe i dobishëm për prodhimin e produkteve të kontraktuara ose për aplikimin e teknologjive të kontraktuara;
- (l)** "i identifikuar" në kontekstin e know-how-it do të thotë se know-how është i përshkruar në mënyrë mjaft gjithëpërfshirëse me qëllim që të mundësohet verifikimi se a i përmbush kriteret e sekretit dhe të rëndësisë;
- (m)** "i përbashkët" në kontekstin e aktiviteteve të kryera me marrëveshjen e kërkimit dhe zhvillimit nënkupton aktivitetet të cilat puna e përfshirë është:
- (i)** e ekzekutuar nga ekipi i përbashkët, organizata ose ndërmarrja e përbashkët,
 - (ii)** besuar bashkërisht një pale të tretë, ose
 - (iii)** shpërndarë midis palëve përmes specializimit në kontekstin e kërkimit dhe zhvillimit ose të përdorimit;
- (n)** "specializimi në kontekstin e kërkimit dhe zhvillimit" nënkupton që secila palë e përfshirë në aktivitetet e kërkimit dhe zhvillimit të pëcaktuara me marrëveshjen e kërkimit dhe zhvillimit dhe që palët në mes vete i ndajnë punët e kërkimit dhe zhvillimit në mënyrën të cilën e konsiderojnë si më të përshtatshme; kjo nuk e përfshin

kërkimin dhe zhvillimin e paguar;

(o) "specializimi në kontekstin e përdorimit" nënkupton që palët në mes vete e bëjnë shpërndarjen e detyrave individuale sikurse që janë prodhimi ose shpërndarja, ose njëritjetrit ia imponojnë përkufizimet e lidhura me përdorimin e rezultateve, sikurse që janë përkufizimet në pikëpamje të territoreve, klientëve ose zonave të caktuara të përdorimit; kjo i përfshin situatat në të cilat vetëm njëra palë prodhon dhe e bënë shpërndarjen e produkteve të kontraktuara bazuar në licencën ekskluzive të cilën ia kanë dhënë palët e tjera;

(p) "kërkimi dhe zhvillimi i paguar" nënkupton kërkimin dhe zhvillimin të cilin e kryen njëra palë, kurse e financon pala tjetër e marrëveshjes;

(q) "palë financuese" nënkupton palën e cila e financon kërkimin dhe zhvillimin e paguar përderisa vetë nuk kryen ndonjë aktivitet të kërkimit dhe zhvillimit;

(r) "ndërmarrësi konkurrues" nënkupton një konkurrent të vërtetë ose të mundshëm;

(s) "konkurenti aktual" nënkupton një ndërmarrës i cili e bënë furnizimin me një produkt, teknologji ose proces i cili mund të përmirësohet, zëvendësohet ose ndërrohet me një produkt ose teknologji të kontraktuar në tregun relevant gjeografik;

(t) "konkurenti potencial" nënkupton ndërmarrjen e cila në mungesë të një marrëveshje të kërkimit dhe zhvillimit, ka gjasa të bëjë investimin e nevojshëm shtesë në rast të ndonjë rritjeje të vogël por të qëndrueshme të çmimeve relative brenda një periudhe jo më shumë se tri (3) vite, mbi një bazë reale, jo thjesht si një mundësi teorike ose kostot tjera të nevojshme të ndërrimit për të furnizuar një produkt, teknologji ose proces që është në gjendje të përmirësohet, zëvendësohet ose ndërrohet me produktin e kontratës ose me teknologjinë e kontratës në tregun relevant gjeografik;

(u) "tregu relevant i produktit" nënkupton tregun përkatës të produktit i cili mund të përmirësohet, zëvendësohet ose ndërrohet me produktet e kontraktuara;

(v) "tregu relevant i teknologjisë" nënkupton tregun përkatës të teknologjisë ose procesit i cili mund të përmirësohet, zëvendësohet ose ndërrohet me teknologjitë e kontraktuara.

2. Për qëllimet e kësaj Rregulloreje, termat "ndërmarrje" dhe "palë" i përfshijnë ndërmarrjet e tyre përkatëse të ndërlidhura, andaj "ndërmarrjet e ndërlidhura" nënkuptojnë:

(a) ndërmarrjet te të cilët njëra prej palëve në marrëveshjen e kërkimit dhe të zhvillimit është në mënyrë të drejtpërdrejt ose indirekte:

(i) e autorizuar ti shfrytëzoj më shumë se gjysmën e të drejtave të votimit,

(ii) e autorizuar të emërojë më shumë se gjysmën e anëtarëve të Bordit Mbikëqyrës, Bordit Drejtues ose të organeve të cilët e përfaqësojnë ligjërisht atë ndërmarrje, apo

(iii) është e autorizuar të drejtojë biznesin e ndërmarrjes;

(b) ndërmarrjet të cilat janë të autorizuar në mënyrë të drejtpërdrejt ose indirekte, që ti mbikqyrin të drejtat ose autorizimet e numëruara nën pikën (a) të palës me marrëveshje të përcaktuar për kërkim dhe zhvillim;

(c) ndërmarrjet te të cilat ndërmarrja e përmendur nën pikën (b) ka të drejta ose autorizime të drejtpërdrejta ose indirekte, të përmendura nën pikën (a);

(d) ndërmarrjet te të cilët pala në marrëveshjen e kërkimit dhe zhvillimit së bashku me një ose më shumë ndërmarrje të përmendura nën pikat (a), (b) ose (c), ose ndër të cilët dy ose më shumë ndërmarrje, bashkërisht kanë të drejta ose autorizime të përmendura nën pikën (a);

(e) ndërmarrjet në të cilat të drejtat ose autorizimet e listuara në pikën (a) mbahen bashkërisht nga:

- (i) palët në marrëveshjen e kërimit dhe zhvillimit ose ndërmarrjet e tyre përkatëse të lidhura, të cilat janë përmendur nga pika (a) deri (d), ose
- (ii) një ose më shumë palë të marrëveshjes së kërimit dhe zhvillimit, ose një e më shumë ndërmarrje të tyre të lidhura e të përmendura nga pika (a) deri në (d) dhe një ose më shumë palë të treta.

Neni 3 Përjashtimi

1. Neni 5 i Ligjit nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës nuk do të zbatohet në lidhje me marrëveshjet e lidhura ndërmjet dy ose më shumë ndërmarrjeve, që kanë për objekt kërkimin dhe zhvillimin, si dhe për sa kohë që këto marrëveshje nuk përmbajnë kufizime të konkurrencës.

Neni 4

Kushtet e përjashtimit

1. Përjashtimi i parashikuar në nenin 3 zbatohet në varësi të kushteve të përcaktuara, nga paragrafi 2 deri në paragrafin 5, të këtij neni.
2. Marrëveshja e kërimit dhe zhvillimit duhet të përcaktojë që të gjitha palët të kenë qasje të plotë në rezultatet përfundimtare të kërimit dhe zhvillimit të përbashkët ose kërimit dhe zhvillimit të paguar, duke i përfshirë të gjitha të drejtat të cilat burojnë nga pronësia intelektuale dhe know-how-i me qëllim të kërimit, zhvillimit dhe shfrytëzimit të mëtutjeshëm, dhe atë posa rezultatet përfundimtare të bëhen të disponueshme. Nëse palët në pajtim me këtë rregullore i kufizojnë të drejtat e tyre të përdorimit, veçanërisht nëse ato specializohen për sa i përket përdorimit, qasja në rezultate me qëllim të përdorimit mund të jetë në përputhje me këtë kufizim. Për më tepër, institutet kërkimore, organet akademike ose ndërmarrjet të cilat ofrojnë kërkim dhe zhvillim si një shërbim komercial pa qenë në menyrë të rëndomtë aktiv në përdorimin e rezultateve, ata mund të pajtohen që ta kufizojnë përdorimin e këtyre rezultateve me qëllim të kërimit të mëtejshëm. Marrëveshja e kërimit dhe zhvillimit mund të përcaktojë që njëra palë t'i jep palës tjetër një kompenzim për dhënien e qasjes në rezultate me qëllim të kërimit ose përdorimit të mëtejshëm, por kompenzimi nuk duhet të jetë aq i lartë sa në esencë ta pengojë qasjen e tillë.
3. Pa e paragjykuar paragrafin 2, atje ku marrëveshja e kërimit dhe zhvillimit parashikon vetëm kërkimin dhe zhvillimin e përbashkët ose kërkimin dhe zhvillimin me pagesë, marrëveshja e kërimit dhe zhvillimit duhet të përcaktojë që seciles palë t'i jepet qasje në cdo know-how para-ekzistues të palës tjetër, nëse ky know-how është i nevojshëm me qëllim të përdorimit të rezultateve. Marrëveshja e kërimit dhe zhvillimit mund të parasheh që palët ta bëjnë kompenzimin e njeri tjetrit për dhënien e aksesit në know-how-in e tyre para ekzistues, por kompenzimi nuk duhet të jetë aq i lartë sa që në menyrë të efektshme ta pengojë qasjen e tillë.
4. Çdo shfrytëzim i përbashkët mund të perket vetëm rezultateve të cilat mbrohen me të drejtat e pronësisë intelektuale ose përbëjnë know-how dhe të cilat janë të domosdoshme për prodhimin e produkteve të kontraktuara ose aplikimin e teknologjive të kontraktuara.
5. Palëve përgjegjëse për prodhimin e produkteve të kontraktuara me anë të specializimit në kontekstin e shfrytëzimit duhet t'u kërkohej ti përmbushin porositë për furnizimet me produkte të

kontraktuara nga palët e tjera, përveç kur marrëveshja e kërkimit dhe zhvillimit parashikon gjithashtu shpërndarjen e përbashkët në kuptim të pikës (m) (i) ose (ii) të nenit 2, paragrafi 1 ose kur palët kanë rënë dakord që vetëm pala e cila i prodhon produktet e kontraktuara mund t'i shpërndajë ato.

Neni 5

Pragu i pjesëmarrjes në treg dhe kohëzgjatja e përjashtimit

1. Kur palët nuk janë ndërmarrje konkurruese, përjashtimi i parashikuar në nenin 3 zbatohet për kohëzgjatjen e kërkimit dhe zhvillimit. Kur rezultatet janë shfrytëzuar bashkërisht, përjashtimi do të vazhdojë të zbatohet për 7 vjet nga koha kur produktet ose teknologjitë e kontratës janë hedhur për herë të parë në treg brenda tregut të brendshëm.

2. Kur dy ose më shumë palë janë ndërmarrje konkurruese, përjashtimi i përcaktuar në nenin 3 vlen gjatë periudhës së referuar në paragrafin 1 të këtij neni vetëm nëse, në kohën e lidhjes së marrëveshjes për kërkim dhe zhvillim:

(a) në rastin e marrëveshjes së kërkimit dhe zhvillimit të referuar në nenin 2(1) pikat (a)

(i), (ii) ose (iii) pjesa e kombinuar e tregut të palëve në marrëveshjen e kërkimit dhe zhvillimit nuk kalon 25% të tregut përkatës të produktit dhe teknologjisë; ose

(b) në rastin e marrëveshjes së kërkimit dhe zhvillimit të referuar në nenin 2(1) pikat (a)

(iv), (v) ose (vi) pjesa e kombinuar e tregut të palës financuese dhe të të gjithë palëve me të cilat pala financuese ka lidhur marrëveshje kërkimi dhe zhvillimi në lidhje me të njëjtat produkte të kontratës ose teknologjitë e kontratës, nuk tejkalon 25% të tregut përkatës të produktit dhe teknologjisë.

3. Pas përfundimit të periudhës së referuar në paragrafin 2, përjashtimi vazhdon të vlejë derisa pjesa e kombinuar e tregut të palëve nuk tejkalon 25% të tregut përkatës të produktit dhe teknologjisë.

Neni 6

Kufizimet e ashpëra

1. Përjashtimi i parashikuar në nenin 3 nuk do të aplikohet për marrëveshjet e kërkimit dhe zhvillimit, të cilat, drejtpërdrejt ose tërthorazi, të vetme ose në kombinim me faktorë të tjerë nën kontrollin e palëve, kanë si objekt ndonjë prej këtyre:

(a) kufizimin e lirisë së palëve për të kryer kërkim dhe zhvillim në mënyrë të pavarur ose në bashkëpunim me palët e treta në fushë që nuk lidhet me atë për të cilën zbatohet marrëveshja mbi kërkimin dhe zhvillimin, domethënë, pas përfundimit të kërkimit dhe zhvillimit të përbashkët ose kërkimit dhe zhvillimit me pagesë, në fushën me të cilën lidhet ose në një fushë të lidhur;

(b) kufizimin e prodhimit ose shitjes me përjashtim të:

(i) përcaktimit të caqeve të prodhimit, ku shfrytëzimi i përbashkët i rezultateve përfshin prodhimin e përbashkët të produkteve të kontraktuara;

(ii) përcaktimit të caqeve të të ardhurave nga shitjet, me anë të të cilave shfrytëzimi i rezultateve përfshin shpërndarjen e përbashkët të produkteve të kontraktuara ose licencimin e përbashkët të teknologjive të kontraktuara në

- kuptim të nenit 2 (1), pika (m) (i) ose (ii);
- (iii) veprimeve që përfaqësojnë specializimin në kontekst të shfrytëzimit; dhe
- (iv) kufizimit të lirisë së palëve për të prodhuar, shitur, caktuar ose licencuar produkte, teknologji ose procese që janë konkurruese me produktet e kontraktuara ose teknologjitë e kontraktuara gjatë periudhës për të cilën palët janë dakorduar të shfrytëzojnë bashkërisht rezultatet;
- (c) caktimin e çmimeve për shitjen e një produkti të kontraktuara ose licencimin e teknologjive të kontraktuara ndaj palëve të treta, në përjashtim të caktimit të çmimeve të ngarkuara për klientët e drejtpërdrejtë ose tarifave të licencës, të ngarkuara për të licencuarit e drejtpërdrejtë, ku shfrytëzimi i përbashkët i rezultateve përfshin shpërndarjen e përbashkët të produkteve të kontraktuara ose licencimin e përbashkët të teknologjive të kontraktuara në kuptim të nenit 2 (1) pika (m) (i) ose (ii);
- (d) kufizimin në territor ku, ose klientët ndaj të cilëve palët mund të shesin në mënyrë pasive produktet e kontraktuara ose të licencojnë teknologjitë e kontrates, me përjashtim që rezultatet të jenë licencuar ekskluzivisht për palën tjetër të marrëveshjes;
- (e) kushtin që shitja aktive e produkteve të kontraktuara ose teknologjive të kontraktuara në territore ose klientë që nuk janë caktuar vetëm për njërin nga palët në marrëveshje përmes specializimit në kontekstin e përdorimit nuk është kryer, ose e kufizuar;
- (f) kushtin për refuzim për të plotësuar kërkesën e klientit në territoret përkatëse të palëve në marrëveshje, ose përndryshe të plasuar për palët përmes specializimit në kontekst të shfrytëzimit, do t'i vendoste produktet e kontraktuara në treg në territoret e tjera brenda tregut të brendshëm;
- (g) kushtin për ta bërë të vështirë për klientët ose shitësit që të marrin produkte të kontratës nga shitësit e tjerë brenda tregut të brendshëm.

Neni 7

Kufizimet e përjashtuara

Përjashtimi i përcaktuar në nenin 3 nuk aplikohet për obligimet në vijim të përfshira në marrëveshjet të kërkimit dhe zhvillimit:

- (a) detyrimin për të mos sfiduar pas përfundimit të kërkimit dhe zhvillimit vlefshmërinë e të drejtave të pronësisë intelektuale që palët kanë në tregun e brendshëm dhe të cilat janë të rëndësishme për kërkim dhe zhvillim ose, pas skadimit të marrëveshjes së kërkimit dhe zhvillimit, vlefshmërinë e të drejtave të pronësisë intelektuale të cilat palët i mbajnë në tregun e brendshëm dhe që mbrojnë rezultatet e kërkimit dhe zhvillimit, pa paragjykuar mundësinë për të parashikuar përfundimin e marrëveshjes së kërkimit dhe zhvillimit në rast se njëra prej palëve sfidon vlefshmërinë e tillë të të drejtave të pronësisë intelektuale;
- (b) detyrimi për të mos dhënë licencë për palët e treta për prodhimin e produkteve të kontraktuara ose për aplikimin e teknologjive të kontraktuara, përveç nëse marrëveshja përcakton që të paktën njëra palë të shfrytëzojë rezultatet e kërkimit dhe zhvillimit të përbashkët ose kërkimit dhe zhvillimit të paguar, dhe një shfrytëzim i tillë bëhet në tregun e brendshëm në raport me palët e treta.

Neni 8

Aplikimi i pragut të pjesëmarrjes në treg

Për qëllime të aplikimit të pragut të pjesëmarrjes në treg të parashikuar në nenin 5 të kësaj rregullore, do të zbatohen rregullat e mëposhtme: **(a)**

pjesëmarrja në treg do të llogaritet në bazë të vlerës së shitjes në treg; nëse të dhënat e vlerës së shitjes në treg nuk janë të disponueshme, vlerësimet bazuar në informacione të tjera të besueshme të tregut, përfshirë vëllimet e shitjeve në treg, mund të përdoren për të vendosur pjesëmarrjen në treg të palëve;

(b) pjesëmarrja në treg do të llogaritet në bazë të të dhënave që lidhen me vitin kalendarik paraardhës;

(c) pjesëmarrja në treg e mbajtur nga ndërmarrjet e përmendura në pikën (e) të nënparagrafit të dytë të nenit 2(2) të kësaj rregulloreje do të ndahet në mënyrë të barabartë për secilën ndërmarrje që ka të drejtat ose autorizimet e listuara në pikën (a) të këtij nënparagrafi;

(d) nëse pjesëmarrja në treg e përmendur në nenin 5(3) fillimisht nuk është më shumë se 25%, por më pas rritet mbi atë nivel pa e tejkalluar 30%, përjashtimi i parashikuar në nenin 3 do të vazhdojë të aplikohet për një periudhë prej 2 vjetësh kalendarik të njëpasnjëshëm pas vitit në të cilin pragu prej 25% u tejkallua për herë të parë ;

(e) nëse pjesëmarrja në treg e përmendur në nenin 5(3) fillimisht nuk është më shumë se 25%, por më pas rritet mbi 30%, përjashtimi i parashikuar në nenin 3 do të vazhdojë të aplikohet për një periudhë prej 1 vite kalendarike pas vitit në të cilin niveli i 30 % u tejkallua për herë të parë ;

(f) përfitimi nga pikat (d) dhe (e) nuk mund të kombinohen në mënyrë që të tejkalojnë një periudhë prej 2 viteve kalendarike.

Neni 9

Dispozitat kalimtare

Në rast të vështirësive për aplikimin e dispozitave të kësaj Rregulloreje apo mungesës së dispozitave për marrjen e vendimit përfundimtar, duhet të aplikohen dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Neni 10

Ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores

Ndryshimin dhe plotësimin e kësaj Rregulloreje mund ta propozojë çdo anëtar i Komisionit të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, e cila bëhet në mënyrën dhe procedurën e paraparë për miratimin e saj.

Neni 11

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.

KOMISIONI I AUTORITETIT KOSOVAR TË KONKURRENCËS

(_____)

Valon Prestreshi
Kryetar

(_____)

Ahmet Krasniqi
Zëvendëskryetar

(_____)

Fatime Haziri
Anëtare

(_____)

Muhamed Krasniqi
Anëtar

(_____)

Shaqir Morina
Anëtar